

VENDIM
Nr. 754, datë 26.10.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 1.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën "a", të pikës 1/3, shtohet emërtesa "Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri).".

b) Pika 10/4 riformulohet si më poshtë vijon:

"10/4. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni", në Agjencinë e Trajtimit të Pronës, të jenë sipas lidhjes nr. 6/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij".

c) Lidhja nr. 6/4, që përmendet në pikën 10/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Nëpunësit e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri), të cilët sipas organizimit të mëparshëm kanë pasur emërtesën "Koordinator" dhe një nivel më të lartë page se përcaktimi i këtij vendimi, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën që kanë pasur sipas organizimit të mëparshëm.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2016:

a) për Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI - Shqipëri), të fillojnë nga data e miratimit të strukturës dhe organikës së re të këtij institucioni;

b) për Agjencinë e Trajtimit të Pronës, të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë dhe të përballohen nga fondet e miratuara për këtë institucion për vitin 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË
PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR
INSTITUCIONI” NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË PRONAVE

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHITESA PËR KUSHTE PUNE
Titullari i institucionit	II-a	1	13.000
Zëvendëstitullari i institucionit	II-b	1	13.000
Drejtor drejtorie	III-a	1	10.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	1	10.000
Përgjegjës sektori	III-b	1	5.000
Inspektor	III-b	1 ose 2	5.000
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3	10.000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	5.000

